

1681

7911



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr. __ Prot.

Tiranë, më 02.09.2020

Lënda: Kthim përgjigjeje

Drejtuar: Qendrës "Res Publica"

Në përgjigje të kërkesës për informacion të bërë nga ana juaj, Ju bëjmë me dije se:

1. Për periudhën mars-korrik 2020 janë organizuar tubime/grumbullime/protesta në 48 raste, në vende të hapura dhe të mbyllura për publikun.
2. Gjatë periudhës **mars-korrik 2020** janë proceduar penalisht gjithsej 307 persona (në lidhje me pjesëmarrjen në tubimet e organizuara), për veprën penale "Organizimi dhe pjesëmarrja në tubime të paligjshme".
3. Ndërsa gjatë periudhës **01.01.2019 - 31.07.2020** janë proceduar penalisht gjithsej 1863 persona (në lidhje me pjesëmarrjen në tubimet e organizuara), për veprën penale "Organizimi dhe pjesëmarrja në tubime të paligjshme".
4. Nuk është dhënë asnjë masë administrative gjatë periudhës mars-korrik 2020, sipas përcaktimeve të nenit 3, pika 2, të Aktit Normativ nr. 3, datës 15.03.2020, në lidhje me pjesëmarrje në aktivitete kulturore, sportive, konferenca apo grumbullime masive, duke përfshirë edhe koncerte.
5. Nuk është dhënë asnjë masë administrative gjatë periudhës mars-korrik 2020, sipas përcaktimeve të nenit 3, pika 2, të Aktit Normativ nr. 3, datës 15.03.2020.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin,

Shefi i Sektorit për Komunikimin me Median dhe Publikun

Drejtues Gentian Mullaj